



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2520, datë 06.11.2014

“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për përdorimin e frekuencave në brezin 1965 - 1970 MHz çiftuar me 2155- 2160 MHz me qëllim ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike për të ofruar shërbime publike të lëvizshme tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 06.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. për përdorimin e frekuencave në brezin 1965 - 1970 MHz çiftuar me 2155- 2160 MHz me qëllim ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike për të ofruar shërbime publike të lëvizshme tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
2. Shkronja g, e nenit 8, nenet 62 deri 79 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”);
3. Vendimi Nr.466, datë 27.2.2013 “Per miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

4. Vendimi Nr. 1252, date 10.9.2008, te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te zhvillimit te tenderit publik, per dhenien e se drejtes se perdorimit te frekuencave" i ndryshuar,
5. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
6. Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.2507, datë 30.10.2014 për " Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz".

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Kopje e Faturave te pagesave të kryera nga sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
- si dhe,
duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr. 2507, datë 30.10.2014, në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz", miratoi:
 - a) Raportin Përmbledhës të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në të cilin sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a renditej i pari nga oferuesit, pra fitues i tenderit të hapur.
 - b) Njoftimin e Fituesit, sipas Shtojca 16 - Formulari i Njoftimit të Fituesit.
2. AKEP, bashkëlidhur shkresës Nr.1915/10 Prot., datë 31.10.2014 i ka dërguar "Vodafone Albania" sh.a., Formularin e Njoftimit të Fituesit, Nr.21915/9 Prot., datë 31.10.2014, sipas Shtojca 16, të përfshirë në dokumentacionin e tenderit.
3. "Vodafone Albania" sh.a brenda afatit 7 (shtatë) ditë, nga data marrjes së Formularit të njoftimit të fituesit, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtëme:
 - a) Çmimin e ofertës me shumën 1.552.001 (një million e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e një) Euro, më datë 04.11.2014, në Logarinë bankare me emërtim: *Qeveria Shqiptare*.

- b) Pagesën për përdorimin e frekuencave të brezit 1965 – 1970 MHz çiftuar me 2155- 2160 MHz, në shumën **233,333** (dyqindë e tridhjetë e tre mijë e treqindë e tridhjetë e tre) lekë, për vitin 2014, më datën 04.11.2014.
- c) Tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për brezat e frekuencave 1965 – 1970 MHz çiftuar me 2155 - 2160 MHz, në shumën 679,140 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e njëqind e dyzetë) lekë, për vitin 2014, më datën 04.11.2014.

Pagesa sipas pika a) të mësipërme, është kryer në Bankën e Shqipërisë, *Qeveria Shqiptare* në EUR me Nr: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E .

Pagesat sipas pika b) dhe c) të mësipërme, janë kryer në llogarinë bankare të AKEP, me Nr: AL30214112090 111113869030117.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gërma g, neni 8, nenet 62 deri 79, neni 114 dhe neni 115 ,
3. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
4. Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.1252, datë 10.9.2008, i ndryshuar,
5. Rregullorja për Autorizimin Individual, miratuar me VKD Nr. 2395 datë. 15.12.2013.

V E N D O S :

1. Të pajisë sipërmarrësin “Vodafone Albania” sh.a me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 1965 – 1970 MHz çiftuar me 2155- 2160 MHz siç përshkruhet në Aneksin 1 bashkëlidhur Autorizimit Individual.
2. Sipërmarrësi duhet të fillojë shfrytëzimin e frekuencave brenda 2 (dy) muajve, nga data e marrjes së këtij Autorizimi Individual.
3. Sipërmarrësi do të ndërtojë dhe konfigurujë rrjetin për të realizuar shtrirjen gjeografike të mbulimit me shërbim, sipas Aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Sipërmarrësi të ofrojë shërbimet e cilësuara, siç përshkruhen në Shtojcën 6 të ofertës së sipërmarrësit.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____